

AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË “Bufi Properties”

KREU I

DATA E THEMELIT, EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, ZYRA QËNDRORE, FORMA E SHOQËRISË

Neni 1

Data e themelimit, Emërtimi dhe Themeluesit

1.1 Sot më datën 04/07/2022 themelohet shoqëria “**Bufi Properties**”.

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:

Bardhul Vreka atësia Lime, i lindur më datë 28/01/1987, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036729744 dhe nr.personal I70128083I

Esmeralda Vreka atësia Gazmend, e lindur më datë 15/01/1988, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 038252298 dhe me nr.personal I85115061Q

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria është person juridik shqiptar.

Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 3


Forma e shoqërisë

3.1 Shoqëria do të ketë formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, derisa me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset shndërrimi i formës ligjore.

Neni 4

Objekti

Shoqëria “**Bufi Properties**” sh.p.k do të ketë si objekt të veprimtarisë:



AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË “Bufi Properties”

Marrje, dhenie me qira afatgjatë, menaxhim, mirëmbajtje, rikonstruksion prona të paluajtshme dhe të luajtshme
Dizenjim, furnizim, zhvillim, instalim dhe mirëmbajtje soft-ware, sisteme të sigurisë, smart-home dhe sisteme të tjera elektronike dhe IT.
Shërbime fotografimi, video ajrore dhe mapping me mjete fluturuese pa pilot, drone.

Neni 5

Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria “Bufi Properties” do të kryej veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 6

Selia

6.1 Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në Tiranë, “Rruga e Dajtit Nd.602 MGB, Seksioni D, Ap. 13, Linze, 1006”. Me vendim të Asmablesë së Përgjithëshme selia e shoqërisë mund të ndryshohet, mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KREU II

KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 7

Kapitali Themeltar

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 (Një qind) lekë, i ndarë në 2 kuota. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet dhe paguhet nga ortakët që zotërojnë 100% të kontributeve të kapitalit përkatësisht:

Bardhul Vreka shtetas shqiptar, i lindur më datë 28/01/1987, me nr. personal I70128083I, zotërues i 1 (një) kuote, 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit.

Esmeralda Vreka atësia Gazmend, e lindur më datë, 15/01/1988, me nr. personal I85115061Q, zotëruese e (një) kuote, 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit.

7.2 Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË “Bufi Properties”

7.3 Orakët e shoqërisë përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e tyre në kapitalin e saj.

Neni 8

Kuotat. Fitimi, Transferimi i kuotave

8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashigimisë, dhurimit, apo çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

8.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

8.3. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së kualifikuar që kërkon ndryshimi i statutit.

8.4. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në QKB, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

8.5. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

8.6. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 9

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

9.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

9.2. Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 10



AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË “Bufi Properties”

Organi Vendimmarrës

10.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim statuti sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

10.2 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për :

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e siper përmendur në shkronjat “c” dhe “ç”
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

10.3 Administratori nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

10.4 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

11.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet e-mail. Njoftimi me shkresë apo me postë elektronike duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

11.2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë së procedurës të thirrjes.

AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË “Bufi Properties”

KREU IV

ADMINISTRATORI

Neni 12

Administrimi i shoqërisë

12.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme. Administrator i shoqërisë do të jetë Zj. Esmeralda Vreka, e bija e Gazmend, e lindur në datën 15/01/1988, me nr. personal I85115061Q banues në Tiranë.

Afati i ushtrimit të detyrës është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit. Përgjegjësitë

13.1 Administratori ushtron kompetencat e mëposhtme:

Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;

Vepron me të tretët në emër dhe për llogari të shoqërisë brenda kompetencave të parashikuara në statut apo/dhe në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë.

Jep urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe vendos sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;

Drejton dhe organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarisë e saj ekonomiko-financiare;

Të raportojë para Asamblesë se Përgjithshme sa herë që Asambleja e kërkon si dhe në rastet kur është i nevojshëm raportimi në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme;

T’i paraqesë në mënyrë të rregullt dhe në kohë të përshtatshme Asamblesë së Përgjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogaritë vjetore si dhe të përgjigjet për to.

Të ushtrojë të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga ligji Nr. 9901. datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË “Bufi Properties”

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit sipas parashikimit të ligjit nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Neni 14

Mbarimi i mandatit të Administratorit

14.1 Mandati i Administratorit përfundon:

- me mbarimin e afatit;
- me shkarkimin e tij nga Asambleja e Përgjithshme ;
- kur vetë Administratori jep dorëheqjen vullnetarisht.
- sipas mënyrave të tjera parashikuar nga ligji nr. 9901 dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 15

Viti Financiar

15.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjithshëm, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 16

Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

16.1 Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

16.2 Shoqëria mund t’u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

16.3 Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e paragrafit 2 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.

AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË “Bufi Properties”

16.4 Pas plotësimit të parashikimeve të paragrafit 2 të këtij neni, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në raport me kuotat e zotëruara.

Neni 17

Ekspertët

17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

17.2 Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t’ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t’i shqyrtuar e miratuar.

Neni 18

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

18.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

18.2 Në këtë rast, Ortakët marrin vendim me shkrim, ku parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1/disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuiduesit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

18.3 Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

18.4 Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë nenet 191 deri në 203 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

18.5 Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË “Bufi Properties”

Neni 19

Baza Ligjore

19.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

19.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Mosmarrëveshjet

20.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente gjykatat shqiptare, sipas Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Dispozita e fundit

21.1 Statuti hyn në fuqi me regjistrimin e tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

21.2 Statuti redaktohet në 2(dy) ekzemplarë me përmbajtje të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe, miratohet nënshkruhet në të gjitha kopjet nga Ortakët themelues të shoqërisë “Bufi Properties”.

ORTAKËT

Bardhul Vreka

Bardhul Vreka



Esmeralda Vreka

Esmeralda Vreka

